



Res Publica &lt;qendra.respublica@gmail.com&gt;

## Kerkese per informacion Nr. Prot 29/26

info akzm <info@akzm.gov.al>  
To: Res Publica <qendra.respublica@gmail.com>

Wed, Mar 11, 2026 at 4:54 PM

Përshëndetje,

Në përgjigje të kërkesës suaj nr. 29/26 prot., datë 26.02.2026, me lëndë "Kërkesë", dërguar në adresën elektronike info@akzm.gov.al dhe protokolluar pranë Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura me nr. 750 prot., datë 02.03.2026, nëpërmjet së cilës kërkohet informacion në lidhje me ndërtimin/forcimin e argjinaturave në lumin Shushicë, në zonën e Drashovicës, ju bëjmë me dije sa vijon:

*1. A është kryer monitorimi mjedisor nga AKZM lidhur me ndërtimin/forcimin e argjinaturave në Lumin Shushicë në zonën e Drashovicës?*

Në kuadër të detyrave të saj ligjore për administrimin dhe monitorimin e zonave të mbrojtura, zona në fjalë ka qenë objekt i monitorimit të vazhdueshëm nga strukturat përgjegjëse të administrimit të zonave të mbrojtura. Gjatë periudhës së administrimit nga Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura Vlorë janë kryer monitorime periodike të territorit, në kuadër të veprimtarisë së rregullt të mbikëqyrjes së zonës së mbrojtur.

Në vijim të riorganizimit institucional dhe në zbatim të VKM nr. 744, datë 13.12.2024, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Administrimit të Parkut Kombëtar "Lumi i Vjosës", duke filluar nga muaji korrik 2025 e në vijim, monitorimi periodik i kësaj zone kryhet nga Zyra e Administrimit të Parkut Kombëtar "Lumi i Vjosës", në vazhdimësi të procesit të monitorimit të territorit të parkut.

*2. Nëse po, ju lutem na vini në dispozicion kopje të raporteve të monitorimit.*

Nga verifikimet dhe monitorimet e kryera në terren rezulton se në zonën e lartpërmendur janë evidentuar ndërhyrje në argjinaturën e lumit pranë fshatit Drashovicë, të cilat konsistojnë kryesisht në vendosjen dhe sistemimin e materialeve inerte (gurë dhe zhavorr) përgjatë brigjeve të lumit, me qëllim forcimin e bregut. Këto ndërhyrje janë evidentuar gjithashtu edhe përmes dokumentimit fotografik dhe imazheve ajrore të realizuara me dron, të cilat paraqesin segmentin përkatës të argjinaturës përgjatë bregut të lumit. Dokumentacioni përkatës i monitorimit administrohet nga strukturat përgjegjëse të administrimit të parkut dhe mund të vihet në dispozicion në përputhje me procedurat dhe rregullat në fuqi për administrimin e dokumentacionit zyrtar.

*3. Kopje të projektit për ndërtimin/forcimin e argjinaturave në lumin Shushicë në zonën e Drashovicës.*

Referuar fushës së përgjegjësisë së saj institucionale, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura është institucioni publik përgjegjës për administrimin dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me ligjin nr. 81/2017 "Për zonat e mbrojtura", i ndryshuar. Në këtë kuadër, AKZM nuk është institucioni hartues apo administrues i projektit për ndërtimin/forcimin e argjinaturave në lumin

Shushicë në zonën e Drashovicës dhe për rrjedhojë nuk disponon projektin përkatës në cilësinë e institucionit hartues apo zbatues të kësaj ndërhyrjeje.

*4. Kopje të lejes/lejeve të dhëna për ndërtimin/forcimin e argjinaturave në lumin Shushicë në zonën e Drashovicës.*

Në lidhje me kërkesën për vënien në dispozicion të kopjes së lejes/lejeve për ndërtimin apo forcimin e argjinaturave në lumin Shushicë, në zonën e Drashovicës, sqarojmë se Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), në përputhje me kompetencat e saj të përcaktuara në ligjin nr. 81/2017 "Për zonat e mbrojtura", i ndryshuar, nuk është institucioni përgjegjës për lëshimin e lejeve, licencave apo autorizimeve për realizimin e punimeve apo ndërhyrjeve të kësaj natyre.

Roli institucional i AKZM në këto raste lidhet me administrimin dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura, si dhe me shqyrtimin dhe dhënien e qëndrimeve institucionale mbi ndërhyrje apo projekte që mund të kenë ndikim në territorin e zonave të mbrojtura, në funksion të ruajtjes së vlerave natyrore dhe të integritetit mjedisor të tyre.

Në këtë kuadër, për rastin në fjalë, bazuar në relacionin teknik dhe specifikimet teknike të paraqitura nga Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura ka shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur dhe ka shprehur qëndrimin e saj institucional nëpërmjet shkresës nr. 3697/1 prot., datë 12.11.2024.

Sa i përket dokumentacionit mbi lejen apo autorizimet përkatëse për realizimin e kësaj ndërhyrjeje, ai administrohet nga institucionet kompetente sipas legjislacionit dhe procedurave në fuqi, të cilat janë përgjegjëse për trajtimin dhe miratimin e këtyre ndërhyrjeve në përputhje me kuadrin ligjor përkatës.

Bashkëlidhur kësaj shkrese gjeni:

- shkresë nr. 3679/1 prot., datë 12.11.2024
- imazh ajror i realizuar me dron, që dokumenton segmentin e argjinaturës.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin,

---

**From:** Res Publica <qendra.respublica@gmail.com>  
**Sent:** Thursday, February 26, 2026 3:41 PM  
**To:** info akzm <info@akzm.gov.al>  
**Subject:** Kerkese per informacion Nr. Prot 29/26

You don't often get email from qendra.respublica@gmail.com. Learn why this is important

**KUJDES:** Ky është një email i ardhur nga jashtë adresave zyrtare qeveritare. Mos klikoni URL-të ose bashkëlidhjet nëse nuk e njihni dhe/ose nuk i besoni dërguesit.

[Quoted text hidden]




Informacioni i trasmetuar në përmbajtje të këtij mesazhi është i destinuar vetëm për individin ose për institucionin të cilit i është nisur, mund të përmbajë materiale konfidenciale dhe / ose të privilegjuara vetëm për marrësin. Çdo rishikim, trasmetim, shpërndarje apo kryerje e ndonjë veprimi tjetër të ngjashëm me këto, nga personat apo nga subjekte të tjera të ndryshme nga marrësi i synuar, është i ndaluar. Nëse merrni gabimisht këtë mesazh, ju lutem kontaktoni urgjentisht dërguesin e tij dhe fshini çdo material të trasmetuar në kompjuterin tuaj. Ne nuk pranojmë asnjë detyrim lidhur me dëmtimin apo humbjen e shkaktuar nga programe të dëmshme apo nga viruse, përveç rastit të neglizhencës së plotë, apo sjelljes së gabuar dhe të qëllimshme.

The information transmitted in the content of this message is intended only for the individual or the institution to whom it is addressed, may contain confidential and/or privileged material for the recipient only. Each review, transmission, distribution or performance of any other action similar to these, by persons or by entities other than the intended recipient, is prohibited. If you receive this message in error, please contact the sender immediately and delete any transmitted material on your computer. We do not accept no liability related to damage or loss caused by harmful programs or viruses, except in the event of gross negligence, or willful misconduct

## 2 attachments



WhatsApp Image 2026-03-07 at 20.44.26 (1).jpeg  
135K

 **Kthim pergjigje DUK Fier.pdf**  
1610K





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E ZONAVE TË MBROJTURA  
DREJTORIA E MENAXHIMIT, MONITORIMIT DHE REGJISTRIT  
SEKTORI I MENAXHIMIT

Nr. 3679/ prot.

Tiranë, më 12.11.2024

DREJTORISË SË UJITJES DHE KULLIMIT FIER  
DREJTOR  
Z. THEODHOR STEFA

Adresa: Lagja "Afrimi i Ri", Rruga e Semanit, 20 metra poshtë shinave të trenit

Për dijeni: **MINISTRISË SË TURIZMIT DHE MJEDISIT**

**ADMINISTRATËS SË ZONAVE TË MBROJTURA, VLORË**

Në përgjigje të shkresës suaj nr. 350 prot, datë 31.10.2024 "Kërkesë për konfirmim projekti i zbatimit "Mbrojtje nga lumi Shushicë në Drashovicë, Selenicë, Vlorë", protokolluar me tonën me shkresë nr. 3679 prot, datë 04.11.2024, drejtuar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, ju bëjmë me dije se:

Referuar dokumentacionit dërguar nga ju (preventivi, relacioni teknik dhe specifikimet teknike), rezulton se projekti do të zhvillohet në zonën e mbrojtur PK "Lumi Vjosë", shpallur me VKM-në nr. 155, datë 13.03.2023 "Për shpalljen e ekosistemit natyror të lumit Vjosa, Park Kombëtar, Kategoria II", pjesa më e madhe në nënzonën qendrore (ZQ) dhe pjesa tjetër në nënzonën e përdorimit tradicional dhe të qëndrueshëm (ZPT/Q).

Referojuni ligjit nr. 81/2017 "Për zonat e mbrojtura", i ndryshuar me Ligjin Nr. 21/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 81/2017 "Për zonat e mbrojtura", nenit 16 pika 2, nenit 33, nenit 48 dhe 49, si dhe VKM-së nr. 155, datë 13.03.2023.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin.

**I KOMANDUAR NË DETYRË  
DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Daniel PIRUSHI**

Konceptori E Dani, Specialist  
R. Llapushi, Specialist GIS  
Konfirmoi: S. Xhepa, Përgj/Sektori  
Miratoi: B. Xhindoli, Drejtor

